



Jakup Keraj (Shkodër, 15 shtator 1933- 7 dhjetor 1987)

“Po fillova të përkufizoj artin, do të shqyrtoja riprodhimin e asaj që ndjesitë perceptojnë në natyrë nëpërmjet vellos së shpirtit. Imitimi i thjeshtë, megjithatë i saktë, i asaj që është në natyrë, i jep të drejtë njeriut të ketë emrin e shenjtë të artistit”

Kjo thënie e Edgar Allan Polle, kujt mund ti rrinte më bukur se një artisti, piktori të talentuar siç ishte Jakup Keraj?!

Jakup Keraj lindi në Shkodër më 15 shtator 1933. Mësimet e para mbi vizatimin dhe pikturën i mori nga mjeshtri shkodran Simon Rrota dhe piktorja ruse, Viktori Puzanova, e cila me punimet e saj konsiderohet si themeluese e bizantologjisë në vendin tonë. Shumë shpejt Puzanova do të kuptonte talentin e piktorit të vogël dhe do ta konsideronte atë si nxënësin e saj të “veçantë”. Në vitet 1947-1951, Keraj do të ndiqte Liceun Artistik “Jordan Misja” në Tiranë, nën drejtimin e piktorëve Abdurrahim Buza dhe Nexhmedin Zajmi. Në vitet 1951-1957 do të studionte në Akademinë e Arteve të Bukura “Ilia Efimoviç Rjepin” Leningrad/Saint Petersburg, përkrah me student të tjerë shqiptarë, sot emra shumë të njohur të pikturës dhe skulpturës shqiptare. Artisti i ri Keraj, që do të formëzohej nën ndikimin e shkollës dhe ambjentit artistik në Rusi, do të ndërthurte aq bukur talentin e lindur nga natyra me impresionet që merrte nga njerëzit. Ndoshta dashuria e tij e parë, ndoshta delikatesa dhe përsosmëria që ai shihte tek femra si krijesë, bënë të mundur që Keraj të realizonte në mënyrë profesionale “Nudot” e tij të para, dy nga të cilat qëndruan në zyrën e Rektorit të kësaj akademie.



“Nudo” skicë e viteve 1951-1957. (Koleksion i familjes Keraj)

Kur po përgatiste tabllonë për të mbrojtur temën e diplomës, në studion e tij për të parë këtë punim, hyri piktori i madh Rumun Corneliu Baba, gjë që tregonte për vlerësimin që i bëhej atij si student i talentuar. Kur mbas disa viteve në po atë akademi do të ishte student Sali Shijaku,

pedagogët do ta thërrisnin atë me emrin Jakopo(Jakup). Diploma me titull ‘‘Çlirimi i grave shqiptare nga turqit osmanë’’ sot ruhet në fondin e Galerisë Kombëtare të Arteve, Tiranë.

Megjithëse talenti i Keraj tashmë ishte bërë i njohur dhe në rrethet letrare, ku flitej nën zë se po vinte ‘‘Mikelanxhelo i dytë’’, fatkeqësisht me mbërritjen në atdhe artisti do të përballej me zhgënjimin e parë. Do të caktohej si mësues vizatimi në një shkollë tetëvjeçare në qytetin e tij të lindjes, në një kohë kur ‘‘elitat’’ e kohës caktoheshin të punonin në Tiranë si profesionistë. Për disa vite si mësues, dha me plot pasion lëndën e vizatimit teknik në shkollën e mesme ‘‘29 Nëntori’’ dhe në shkollën pedagogjike ‘‘Shejnaze Juka’’. Më pas u caktua në shkollën e mesme artistike ‘‘Prekë Jakova’’ po në Shkodër, si mësues i pikturës dhe vizatimit, njëkohësisht dhe në lëndët e perspektivës dhe anatomisë, ku vazhdoi të punojë me përkushtim në përgatitjen e piktorëve të rinj, disa nga të cilët sot janë bërë të njohur si Merita Selimi apo Adnan Kastrati.

Keraj tregoi se talenti nuk mund të ndalet nga asgjë, me aftësinë e lindur për ti kapur gjërat ‘‘alla prima’’ prodhimitaria e tij artistike përveçse e shumtë është sa realiste po aq edhe ekspresive. Në tablot, nudot, portretet, peisazhet, natyrën e qetë dhe vizatimet e shumta , mund të gjejmë Realizmin nga Caravaggio, Penelata të Rembrandt-it, Natyrën nga Shishkin apo Ekspresivitet nga Goya. Ai gjithashtu solli një risi dhe mjeshtëri në gjininë e portretit në Shqipëri ku nëpërmjet vështrimit të modeleve përcillte psikikën e individit. Disa nga portretet e realizuara janë ‘‘Vajza me pëllumb’’, ‘‘Portret’’ që i realizoi vajzës së tij të madhe Linditës, ‘‘Autoportret’’, etj.

‘‘Vajza me pëllumb’’ (GKA-Shkodër)



‘‘Portret’’ (Koleksion familjar)



‘‘Autoportret’’ (GKA- Tiranë)



Gjithashtu po kaq mjeshtërisht realizoi dhe gjininë e peisazhit, ku vihet re ndikimi i impresionizmit për të paraqitur menjëherë përshtypjet e çastit nëpërmjet përjetimit personal dhe përdorimin e penelatave të forta me praninë e ngjyrës blu.

“Porta e kalasë”, (Koleksion familjar)




“Shkodra”, viti 1966 (Koleksion familjar)



“Thethi” (Koleksion familjar)



“Peisazh” (Koleksion familjar)



PEISAZH NGA RRETHINAT SHKODER. VAJ, DIM 30X40 CM. KOLEKSION FAMILJAR.

Etydet gjithashtu do të ishin një nga mënyrat më të fuqishme nëpërmjet të cilave ai arriti të shprehej, një i tillë ishte me temën “Kuvendi i Lezhës” i cili nuk gjendet më në GKA , por një foto gjendet në Muzeun Kombëtar të Krujës, si dhe është i materializuar në një pullë postare të vitit 1959.

Bocet ‘Kuvendi i Lezhës’ (GKA- Shkodër)



Keraj la një trashëgimi të madhe në artin Shqiptar nëpërmjet rreth 130 vizatimeve, 60 pikturave pa përmendur bocete apo akuarele të cilat janë pjesë e koleksionit familjar, ndërsa rreth 70 punime janë pjesë e fondit të GKA në Shkodër dhe Tiranë si dhe në Muzeun Historik të Shkodrës. Në secilin nga këto punime mund të kuptosh fare lehtë ndërthurjen e poezisë së botës së brëndshme me atë të penelatave.

Përkushtimi dhe respekti ndaj familjes, gruas së tij Nezit dhe fëmijëve, Linditës, Albanës dhe Petritit, do të ishte një tjetër tipar i piktorit. Albana dhe Petriti ndoqën gjurmët e babait në rrugën e artit, njëri piktor dhe tjetri skulptor.

Trashëgimia që artisti Keraj na la pas tregoi se ‘‘Në kundërshtim me besimin e përgjithshëm, një artist nuk është kurrë përpara kohës së vet, por shumica e njerëzve janë pas tij’’.(Edgard Varèse)

Një falenderim i veçantë shkon për familjarët dhe studion ‘‘Sinaj’’ të cilët më ndihmuan në jetëshkrimin e tij, si dhe të drejtën e përdorimit të fotove që i përkasin koleksionit të familjes. Një falenderim për fondin e përdorur nga GKA Tiranë dhe Shkodër. Falenderim dhe për prof. Shpend Bengu që mundësoi foton e profilit.

Përgatitur nga: Valbona Berdica, Biblioteka Shkencore e Universitetit ‘‘Luigj Gurakuqi’’

Shkodër, më 7 dhjetor 2020